

LIGJ
Nr.7648, datë 16.12.1992

PËR NJË NDRYSHIM NË LIGJIN NR.7560, DATË 28.4.1992 "PËR SISTEMIN BANKAR NË SHQIPËRI"

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me propozim të një grupi deputetësh,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Në ligjin nr.7560, datë 28.4.1992 "Për sistemin bankar në Shqipëri" pas nenit 8 të shtohet neni 8a me këtë përmbajtje:

"Krijimi i bankave private ose shtetërore me kapital shqiptar dhe të huaj, me propozim të Këshillit të Ministrave miratohet edhe nga Kuvendi Popullor".

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi menjëherë.

Shpallur me dekreten nr.407, datë 31.12.1992 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Sali Berisha